

## EMËRTIME NJERËZISH ME EMRA TË BOTËS SHTAZORE NË GJUHËN SHQIPE

Idriz METANI  
Tiranë

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Pamja me të cilën shfaqet sot në leksikun e shqipes mikrofusha e emërtimeve të njerëzve me emra të botës shtazore në gji të makrofushës leksikore të emërtimeve të njerëzve sipas dukës së jashtme e tipareve morale në tërësi, është pasojë e ndryshimeve semantike të mëdha e të thella që kanë ndodhur në të në rrjedhën e viteve në mënyrë të shkallëshkallëshme.

Këto ndryshime a zhvillime kuptimore janë objekt i artikullit të pranishëm, i cili mëton t'i japë ato në mënyrë sa më të plotë e me të gjithë spektrin e tyre për të zbuluar, përveç të tjerave, edhe cilësitë a tiparet e gjallesave të botës shtazore që figurativizohen duke u kthyer në semantema a tema semantike për të mundësuar lindjen e kuptimeve të figurshme metaforike me anën e të cilëve emërtohen njerëzit sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe.

**Fjalë çelësa:** Gjuhë shqipe, leksik, klasë leksikore, emërtime, ndryshime semantike.

Artikulli i pranishëm ka për objekt hulumtimi specifikisht emërtimet e njerëzve me emra të botës shtazore, të cilët, brenda makrofushës së emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në tërësi, formojnë një fushë leksiko-semantike që mbart disa tipare të përgjithshme: a) është e njësuar nga pikëpamja leksiko-gramatikore, leksiko-fjalëformuese dhe

leksiko-semantike; b) ka lidhje të brendshme sistemore dhe ideografike si nga pikëpamja e burimit të emërtimeve, ashtu edhe nga pikëpamja shenjuese e karakterizuese, sipas një tipologjie të rregullt; c) ka pësuar zhvillime e lëvizje kuptimore që mund të përshkruhen e të sistemohen në kategori më të mëdha semantike.

Qëllimi kryesor i artikullit është të kundrojë në tërësi fushën leksikore të emërtimeve të njerëzve me emra të botës shtazore për të parë më nga afër e në thellësi të gjitha zhvillimet kuptimore që kanë ndodhur në të duke analizuar sidomos blloqet metaforike që krijohen si rezultat i këtyre zhvillimeve. Blloqet metaforike janë në të vërtetë blloqe semantike që krijohen, krahas blloqeve të tjera kuptimore, brenda strukturës semantike të fjalëve, por ne i kemi quajtur këtu të tilla, pra metaforike, për të treguar se derivacioni semantik i emrave për të cilët po flasim ka në themel të tij metaforën, si njërin prej translanteve kryesore mbi bazën e të cilit këta emra janë rikuptimësuar duke përfutur kësajsoj kuptime të figurshme që karakterizojnë njerëzit sipas tipareve fizike e morale.

Në leksikun e gjuhës shqipe ka me dhjetëra klasa leksikore, semantike e fjalëformuese, të cilat presin të studiohen më në thellësi, kryesisht në anën më të rëndësishme të tyre, në rrafshin semantik. Njëra prej tyre është klasa leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale<sup>1</sup>, e cila formon një makrofushë leksiko-semantike që përfshin, krahas mbiemrave cilësorë, të panyjshëm e njëjësive frazeologjike, edhe një sasi emrash të botës shtazore, të cilët i janë nënshtruar procesit të risemantizimit dhe kanë zhvilluar kuptime të figurshme që përdoren në shqipe për të emërtuar cilësi fizike e cilësi të karakterit a të natyrës mendore të njeriut.

Me tipare fizike këtu kuptohen cilësitë e jashtme të trupit të njeriut e të pjesëve të tij të veçanta (format dhe përmasat, madhësia dhe vogëlsia, hollësia e trashësia, gjatësia dhe shkurtësia, zhdërvjelltësia e ngathtësia, pastërtia e papastërtia, eleganca, delikatesa etj.), kurse me tipare morale kuptohen cilësi të qenësishme të njeriut (vetitë e karakterit, të personalitetit, të formimit në përgjithësi, të temperamentit e të sjelljes, veset, virtytet, cilësitë e botës mendore të njeriut etj.).

<sup>1</sup> Klasa leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale është bërë objekt studimi fillimisht në punimin tonë të doktoratës “Fusha leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe”, Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Historisë e i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, 1997; pas disa vitesh ky punim u rivështrua e u botua si monografi me titull “*Semantika leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*”, Tiranë, 2019.

Përmbledhtazi, mund të themi se studimet e deritanishme në gjuhësinë shqiptare i kanë parë emërtimet e njerëzve sipas tipareve fizike e morale, pra edhe emërtimet e njerëzve me emra të botës shtazore që janë objekt i këtij artikulli, në këndvështrimin thjesht gramatikor dhe kësisoj, edhe pse ia kanë mbërritur të dallojnë qartë ç'është gramatikore tek këto emërtime, duke sjellë njëherazi, qoftë edhe në mënyrë empirike, disa elemente të semantikës leksikore, nuk kanë mundur të ndriçojnë sa duhet rrafshin leksiko-semantik të tyre.

Artikulli ka si synim kryesor të analizojë zhvillimet semantike që kanë ndodhur ndër emrat e botës shtazore si pasojë e përfshirjes së tyre në procesin e metaforizimit gjuhësor a të rikuptimësimit, i cili, sipas nesh, ka, së paku, dy karakteristika kryesore: a) bashkekzistencën paralele të kuptimit të parë të fjalës dhe të kuptimit metaforik. I dyti, pra kuptimi i figurshëm metaforik, projektohet, si të thuash, mbi të parin dhe është i qartë e i kuptueshëm vetëm se del në sfondin e tij. Bashkekzistenca e kuptimeve jep mundësi për formimin e metaforave në bazë të të cilave qëndron kundërvënja dy rrafsheve të ndryshme kuptimore: të drejtpërdrejtë dhe figurativ; b) abstraktimin e një tipari të spikatur të realies, i cili mund të figurativizohet lehtë. Kështu, emërtimi *thëllëzë* për një vajzë të bukur lidhet me përfytyrimin e bukurisë, kurse emërtimi *ujk* për një njeri të egër e të pangopur lidhet me përfytyrimin e egërsisë e të makutërisë. Këto tipare (i bukur dhe i egër e i pangopur) që mund të figurativizohen me lehtësi, abstraktohen dhe formojnë bazën e kuptimeve metaforike: *thëllëzë* “vajzë e bukur”; *ujk* “njeri i egër dhe i pangopur”.

Po ashtu, artikulli mëton të vërë në dukje perceptimin social, “uzusin” e emërtimeve, si edhe të argumentojë karakterin vetjak të procesit të rikuptimësimit për disa gjallesa që i janë nënshtruar këtij procesi e që janë kthyer në simbole të disa attributeve njerëzore, fjala vjen, *dhelpira* është simbol i dinakërisë, *gomari* është simbol i budallallëkut, por edhe i durimit e i qëndrësës etj. Studimet shqiptare në fushën e semantikës<sup>2</sup>, kësaj “bije të

<sup>2</sup> Shih, ndër të tjera: A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, Studime për fjalëformimin dhe leksikon, III, Tiranë 2017, f. 5 -38, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, III, Tiranë, 2017, f. 39 – 88, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, III, Tiranë, 2017, f. 109 – 182, *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, III, Tiranë, 2017, f. 215 – 228; J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe* (botim i ripunuar e i përmirësuar), Tiranë, 2009; V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999; I. Metani, *Semantika leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2019.

varfër të lingistikës”, siç e quante këtë disiplinë gjuhësore gjuhëtari i njohur francez A. J. Greimas<sup>3</sup> në fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, janë të pakta dhe disi të vonuara, prandaj analiza kuptimore e gjuhës shqipe, që përbën pjesën thelbësore të saj, mbetet edhe sot e gjithë ditën më pak e studiuar se forma. Rrafshi përmbajtjesor i gjuhës është vërtetë i gjerë me çështje të ndëlikuara, por njëherazi dhe shumë të rëndësishme për të kuptuar tërë mekanizmin e funksionimit të gjuhës, për të hyrë në thellësi të saj e për të zbuluar prej andej vlera cilësore të pafund që fsheh, sidomos semantika leksikore.

Po kështu, siç e kemi pohuar më lart, edhe emërtimet e njerëzve me emra të botës shtazore që përbëjnë objektin e i këtij artikulli, nuk janë studiuar deri më sot në tërësi, megjithëse kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen e gjuhëtarëve, të cilët, në gji të studimeve jo të drejtpërdrejta për këtë klasë fjalësh kanë vënë në dukje herë aspekte të semantikës së saj dhe herë pasurinë e laryshinë nga pikëpamja e ndërtimit formal.

Artikulli i pranishëm ka si qëllim kryesor të hulumtojë strukturën kuptimore të emrave të botës shtazore për të parë ndryshimet që kanë ndodhur në semantikën e tyre për shkak të përfshirjes së këtyre emrave në procesin e risemantizimit a, siç quhet ndryshe, të metaforizimit gjuhësor.

Studimet në fushën e semantikës<sup>4</sup> kanë dëshmuar tashmë se kuptimet leksikore të fjalëve të pranishme në strukturat kuptimore të tyre ndërtohen nga njësi semantike minimale, të cilat janë quajtur në fillim *komponentë semantike* dhe, më pas, sipas autorëve të ndryshëm<sup>5</sup> e drejtimeve gjuhësore që ata ndjekin: *përbërës semantik*, *tipare semantike*, *sema*, *plerema*, *noema*, *unitete semantike* etj., ndërsa metoda me anë të së cilës këta komponentë zbulohen brenda strukturës së kuptimit mori emrin *metoda e analizës komponentiale*<sup>6</sup>

Nëpërmjet kësaj metode që përdoret gjerësisht në artikullin e pranishëm në bashkëlidhje me metodën e analizës semike, si edhe me metodën e krahasimit e të ballafaqimit të strukturave semantike, kemi mundur të depërtojmë në thellësi të strukturave kuptimore të emrave të botës shtazore për të analizuar, siç e kemi thënë edhe diku më lart, të gjitha ndryshimet

<sup>3</sup> A. J. Greimas, *Semantika structural*, 1972, f. 67.

<sup>4</sup> Shih, ndër të tjerë, S. Ullman, *The Principles of semantics*, 1957; J. Lyons, *Semantics*, 1977.

<sup>5</sup> J. J. Katz – J. A. Fodor, *The structure of a semantics Theory*, *Language*, 39, 1963; L. Prieto, *Principes de noologie: fondements de la theorie fonctionelle du signifie*, 1964; W. L Chafe, *Language as Simbolization*, *Language*, 1967, 1, f. 57 – 91.

<sup>6</sup> E. Nida, *Morphology: the descriptive Analysis of Words*, 1949.

kuptimore që kanë ndodhur ndër to si rezultat i përfshirjes së tyre në procesin e rikuptimësimit.

Emërtimet e njerëzve me emra të botës shtazore mund t'i ndajmë më tej në disa mikrofusha leksikore:

**1. Emërtime njerëzish me emra kafshësh shtëpiake:** *at* “kalë shale” dhe “njeri i fuqishëm, i shkathët, i zoti për punë”; *atkinë* “pelë shale” dhe “vajzë a grua e re, e fuqishme, e shkathët dhe e zonja për punë”; *bagëti* “kafshë shtëpiake a gjë e gjallë që mbahet për prodhim dhe për punë bujqësore” dhe “njeri i trashë e i pagdhendur; njeri i paditur”; *balash* “kalë ose ka me një balë të bardhë në ballë ose me bala në trup”, “njeri me flokët ose me qimet e fytyrës krejt të bardha” dhe “njeri i paturp, njeri të cilit i ka plasur cipa”; *balo* “qen ose ka me një balë të bardhë në ballë a në tur”, “njeri me flokët e qimet e fytyrës krejt të bardha, çubardh” dhe “njeri që e dinë të gjithë se është i keq, njeri me damkë”; *ballëhënë* “lopë me një balë të bardhë në ballë” dhe “grua a vajzë me ballë të gjerë e të bukur, ballëndritur”; *bardho* “qen, kalë ose ka i bardhë” dhe “njeri me flokë të bardhë, balash”; *bardhonjë* “kafshë shtëpiake (lopë, dhi, pelë, mushkë) e bardhë ose e bardheme” dhe “vajzë a grua me lëkurë shumë të bardhë, bardhoshe”; *bec* “qengj i vogël” dhe “njeri i urtë e i butë (zakonisht për fëmijët)”; *bejkë* “dele krejt e bardhë” dhe “vajzë e re, bardhoshe dhe e hijshme”; *bisbiq* “dele a dash me trup të imët e të dobët, zakonisht i pashtuar e që ndahet nga tufa” dhe “njeri me trup të vogël e të hequr, por shumë i lëvizshëm; llafazan e ngatërrestar, mistrec”; *borrokoç* “viç i ri, mëzat; ka i patredhur; dem me trup të vogël” dhe “djalë i ri me trup të ngjeshur e të fuqishëm”; *bryme* “dhi me qime bojëhiri në të errët” dhe “grua thuajse e thinjur”; *buall* “kafshë me trup të madh e të rëndë” dhe “burrë me trup të madh e të rëndë, i ngathët dhe i trashë nga mendja”; *dele* “kafshë shtëpiake e imët, me lesh të butë” dhe “njeri shumë i urtë e i padjallëzuar; grua a vajzë kokulur dhe e bindur”; *dem* “ka i ri e i patredhur” dhe “djalë i shëndoshë e i fortë”; *derr* “kafshë me trup e me qafë të trashë”, “njeri shumë këmbëngulës, i fortë e kryeneç” dhe “njeri shumë i trashë e i majmur; njeri që nuk e mban veten pastër; njeri i trashë nga mendja e kokëfortë; njeri i ndyrë e i keq, maskara”; *dërdyl* “kalë me trup të madh e të fuqishëm” dhe “burrë me trup të madh e të shëndoshë”; *gërdallë* “kalë i vjetër e i dobët” dhe “njeri me trup të gjatë e shumë të dobët; njeri i plakur e shëndetlig”; *gic* “i vogli i derrit” dhe “fëmijë topolak; fëmijë shumë i shëndoshë”; *gomar* “kafshë me kokë të madhe, që mbahet në shtëpi për ngarkesë” dhe “njeri i trashë nga mendja, budalla”; *grivol* “kalë me qime të përhimë” dhe “burrë gjysmë i thinjur,

thinjosh”; *ftujak* “kec mashkull nga një vit deri në dy vjeç” dhe “djalë i ri i njomë e i shëndetshëm, por ende i papjekur e pa përvojë nga jeta”; *hajvan* “kafshë ngarkese” dhe “njeri i trashë nga mendja”; *hamshor* “kalë i patredhur, që mbahet për ndërzim” dhe “njeri i ushqyer mirë, i fortë e i papërmbajtur”; *hergjele* “tufë kafshësh të ngarkesës që janë lënë të lira të kullojnë në natyrë” dhe “vajzë a grua e re dhe e shëndoshë; femër e papërmbajtur dhe e harbuar”; *kafshë* “qenie e gjallë që s’është në gjendje të mendojë e të veprojë në mënyrë të vetëdijshme” dhe “njeri i trashë e i pasjellshëm”; *kërmë* “kufomë e një kafshe të vrarë ose të ngordhur”, “mish shumë i dobët, pa dhjamë” dhe “njeri shumë i dobët nga trupi”; *kërthi* “qengj ose kec që është pjellë më vonë se të tjerët”, “fëmijë që ka lindur më prapa se të tjerët”, “fëmijë i vogël e i dobët” dhe “njeri i papjekur”; *kërriç* “i vogli i gomaricës” dhe “djalë i ri, jo i zgjuar a mendjehhtë ose pa përvojë në jetë; njeri i papjekur”; *kuqal* “ka, cjav etj. me qime të kuqe”, “njeri me flokë e fytyrë si më të kuq” dhe “njeri me bark të madh e trup të shëndoshë”; *kuqo* “kafshë (kalë, qen, dash, cjav etj.) me qime si të kuqe” dhe “njeri me flokë e me fytyrë në ngjyrë si të kuqe”; *lac* “i vogli i buallicës” dhe “njeri i fortë, me trup të ngjeshur e të lidhur mirë”; *lakoç* “ka a kalë i tredhur” dhe “burrë i paaftë për seks”; *langua* “qen i shpejtë, me trup të zhdërvjellët e që gjuan mirë” dhe “njeri i shkathët e i mprehtë, që i nuhat shpejt gjërat”; *laro* “qen i larmë” dhe “njeri i pabesë e tradhtar; ai që i shërben si qen një tjetri për të përfituar diçka prej tij; ai që e shet veten për një kockë”; *lepec* “ka i vjetër” dhe “njeri i shkuar në moshë e shëndetlig”; *lopëlarë* “lopë e larme” dhe “njeri që ha shumë, hamës i madh, grykës”; *lush* “qen mashkull” dhe “njeri i papërmbajtur, ai që bën si i tërbuar”; *llangos* “qen që leh e s’të ha, qen rrugësh” dhe “njeri llafazan, njeri që endet derë më derë e rri pa punë”; *lukër* “qengj i vogël” dhe “fëmijë i vogël, vocërrak”; *mace* “kafshë e vogël shtëpiake, me kthetra të forta”, “grua a vajzë shumë e dobët nga shëndeti” dhe “grua a vajzë e egër e grindavece”; *maçok* “mashkulli i maces” dhe “njeri i prapë, që s’rri urtë e grindet; njeri dinak”; *manare* “qengje e butë, që është mësuar të ndjekë pas bariun a të zotin” dhe “fëmijë i urtë e i përkëdhelur, që s’u ndahet prindërve”; *ngordhësirë* “kufomë kafshe”, “njeri shumë i dobët, që mezi mbahet në këmbë” dhe “njeri që nuk është i zoti për asgjë”; *ogiç* “qengj i urtë, që i shkon pas bariut a një fëmije” dhe “njeri i urtë, i bindur, që shkon gjithnjë pas dikujt”; *përçor* “dashi a cjapi që i prin tufës” dhe “njeri që u prin të tjerëve në luftë a në punë të guximshme”; *qen* “kafshë shtëpiake me nuhatje shumë të mirë” dhe “njeri i keq, i pabesë e shumë i ulët”; *qengj* “i vogli i deles pa mbushur vitin” dhe “njeri i butë e i urtë (zakonisht për fëmijë)”; *rrol* “ka i vjetër, që

s'bën më për të punuar në pendë”, “njeri i plakur e i rënë” dhe “njeri i pazoti për punë”; *rrole* “lopë plakë” dhe “grua e plakur dhe e rënë”; *sheleg* “qengj që s’ka mbushur vitin” dhe “fëmijë i urtë e i butë”; *thi* “derr” dhe “njeri i fortë, me durim të madh, i qëndrueshëm e i paepur; njeri që s’pyet për asgjë”; *viç* “i vogli i lopës, i drerit a i disa kafshëve të tjera deri në një vit” dhe “njeri i papjekur nga mendja; njeri i trashë e pa përvojë”; *viçok* “viç motak” dhe “njeri i papjekur”; *zagar* “qen gjahu”, “shërbëtor i bindur e i përrulur i dikujt” dhe “burrë a djalë që sillet kot rrugëve e bredh pas femrave”; *zekë* “lopë a dele fare e zezë” dhe “grua a vajzë ezmere” etj.

Duke i parë emërtimet e mësipërme në rrafshin semantik, del se ato janë krijuar, siç e thamë diku më lart, në procesin e metaforizimit gjuhësor sipas një cilësie, karakteristike a tipari të kafshës, kur njeriu është i ngjashëm në atë cilësi, karakteristikë a tipar. Si të tilla mund të përmendim:

A) *ngjyra*: a) sipas ngjyrës së bardhë të krejt trupit të kafshës emërtohet një vajzë e re, bardhoshe dhe e hijshme; një vajzë ose një grua me lëkurë shumë të bardhë; një njeri me flokë të bardhë: *bejkë, bardhan, bardhonjë, bardho*; b) sipas ngjyrës së bardhë të një shenje të veçantë në ballë a në turi të kafshës emërtohet një njeri me flokët e me qimet e fytyrës krejt të bardha; një njeri që e dinë të gjithë se është i keq, një njeri me damkë: *balo*; c) sipas ngjyrës së bardhë të një shenje a bale në ballë ose të shumë balave në trup të kafshës emërtohet një njeri i paturp, të cilit i ka plasur cipa fare: *balash*; ç) sipas ngjyrës së larme të trupit të kafshës emërtohet një njeri i pabesë e tradhtar, që i shërben si qen një tjetri për të përfituar diçka prej tij, që e shet veten për një kockë; një njeri që ha shumë: *laro, loplari*; d) sipas ngjyrës së kuqe të qimeve të kafshës emërtohet një njeri me flokë e me fytyrë në ngjyrë si të kuqe si dhe një njeri me bark të madh e trup të shëndoshë: *kuqal, kuqo*; dh) sipas ngjyrës së zezë të trupit të kafshës emërtohet një grua a vajzë ezmere: *xebë, zekë*; e) sipas ngjyrës bojëhiri në të errët të qimes së dhisë emërtohet një grua pothuajse e thinjur krejt: *bryme*; ë) sipas ngjyrës së përhime të qimes së një kali emërtohet një burrë gjysmë i thinjur a thinjosh: *grivol*;

B) *mosha*: a) sipas moshës deri në një vit të viçit a të viçes emërtohet një njeri i papjekur; një vajzë e vogël, e shëndetshme dhe e bukur; një njeri i trashë nga mendja e pa përvojë: *viçok, viçoke, viç, viçe*; b) sipas moshës nga një vit deri në dy vjeç të kecit emërtohet një djalë i ri, i shëndetshëm, por ende i papjekur e pa përvojë nga jeta; një vajzë e re, e njomë e plot shëndet: *fujak, fujë*; c) sipas vjetërsisë në moshë të lopës a të kaut

emërtohet një grua e plakur dhe e rënë, si dhe një njeri i shkuar në moshë e shëndetlig: *rrole, lepec*;

C) *përmasat e trupit të kafshëve*, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup shumë të madh a shumë të vogël: a) madhësia e trupit të kafshës, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup të madh e të rëndë: *buall, buallicë, lopë*; b) vogëlsia e trupit të kafshës, sipas së cilës emërtohet një njeri i vogël e i njomë: *mi, miush, lepurush*; c) dobësia e trupit të kafshës, sipas së cilës emërtohet një njeri shumë i dobët nga trupi, kockë e lëkurë, që mezi mbahet në këmbë; një njeri që nuk është i zoti për asgjë: *kërmë, ngordhësirë*;

D) *pamja e jashtme e dashit a e cjamin* me një bri të thyer, si dhe duka e të voglit të dërrit a të buallicës, sipas së cilës emërtohet një njeri i shëndoshë, i bukur dhe i hijshëm, një fëmijë topolak e shumë i shëndoshë; një njeri i fortë, me trup të ngjeshur e të lidhur mirë: *dash, gic, loc*;

Dh) *aftësia seksuale e kafshës*, sipas së cilës emërtohet një grua a vajzë e përdalë e bishtdredhur; një njeri i papërmbajtur, që bën si i tërbuar; një njeri i paaftë seksualisht: *kuçkë, lakoc, lush, lushë, zagar*;

E) *pavetëdija e kafshëve* sipas së cilës emërtohet një njeri i trashë e i pagdhendur, një njeri i paditur a i pasjellshëm: *bagëti, hajvan, kafshë, shtazë*;

Ë) *butësia a urtësia e disa kafshëve shtëpiake të imta*, me lesh të butë, sipas së cilës emërtohet një njeri shumë i urtë e i padjallëzuar, si dhe një grua a vajzë kokulur dhe e bindur: *dele, qengj*.

Si temë semantike (semantemë) për emërtimet e njerëzve me emra kafshësh shtëpiake nuk shërben vetëm një cilësi e tyre, por mund të jenë dy a tri të tilla. Po përmendim disa syresh: a) urtësia ose butësia + zakoni i të ndjekurit pas të qengjit të butë, sipas të cilave emërtohet një fëmijë i urtë e i përkëdhelur, i cili s'u ndahet prindërve a dikujt tjetër; një njeri i urtë e i ushqyer mirë, që shkon gjithnjë pas dikujt: *bec, manar, oqiç*; b) madhësia e trupit + ngathtësia në lëvizje që kanë zakonisht kafshët shtëpiake ripërtypëse e dythundrake me trup të madh, sipas të cilave emërtohet një njeri trupmadh e i rëndë; një njeri i ngathët e i trashë mendërisht: *buall, buallicë, lope*; c) lehja + tërheqja e qenve pas një bushtre, sipas të cilave emërtohet një grua llafazane e ngatërrestare; një grua e shturur, e ligë, e përdalë e bishttundur: *bushtër, gorre, meçkë, shake*; d) madhësia e kokës + gjatësia e veshëve të gomarit, sipas të cilave emërtohet një njeri i shëmtuar e i trashë nga mendja, budalla: *gomar*; për gra: *gomaricë*; dh) mosha e re + vogëlsia e trupit e të voglit të gomaricës, të pulishtit, sipas të cilave emërtohet një djalë i ri, jo i zgjuar a mendjelehtë, që nuk ka përvojë në jetë, i papjekur: *kërkë, kërric, pulisht*; e) mosha e re + gjatësia + aftësia për të përballuar punë të

rënda e kalit a e pelës së shalës, sipas të cilave emërtohet një njeri i fuqishëm e i shkathët, i zoti për punë, si dhe një vajzë a grua e fortë e shkathët dhe e aftë: *at, atkinë, mushkë*; ë) mosha e re + butësia + urtësia e të voglit të deles që nuk e ka mbushur vitin, sipas të cilave emërtohet një fëmijë i urtë, i butë dhe i bindur: *qengj, sheleg, shelege, shtjerrë*; f) mosha e vjetër + dobësia trupore e një kali a pele, ose e një kau, sipas të cilave emërtohet një njeri me trup të gjatë e shumë të dobët; një njeri i plakur e tepër i rënë, i pazoti për punë: *gërdall, rrol*; g) dobësia trupore + lëvizshmëria + zakoni i ndarjes prej tufës të një deleje a dashi, sipas të cilave emërtohet një njeri zakonisht trupvogël dhe i hequr, por tepër i lëvizshëm; një njeri mistrec, llafazan e ngatërrestar: *bisbiq*; gj) trashësia e trupit dhe e qafës + papastërtia + ngathtësia + kokëfortësia e derrit a e dosës, sipas të cilave emërtohet një njeri shumë i majmur; një njeri që nuk e mban veten pastër; një njeri shumë këmbëngulës, i fortë e kryeneç; një njeri i trashë nga mendja e kokëfortë; një njeri i ndyrë, i keq e maskara: *derr, derre, thi, thineshë*; për femra edhe pjelloria e madhe: *dosë*; h) forca + energjia + aftësia seksuale e një kali të patredhur që mbahet për ndërzim, sipas të cilave emërtohet një njeri i ushqyer mirë, i fortë e i papërmbajtur: *hamshor*; i) mosha e njomë + vogëlsia + dobësia e trupit e një pjelle qumështi të një kafshe, sipas të cilave emërtohet një fëmijë i vogël e i dobët; një njeri i papjekur: *kërthi*; j) zhërvjelltësia + shpejtësia + aftësia për të gjuajtur e qenit, sipas të cilave emërtohet një njeri i shkathët e i mprehtë, që i nuhat shpejt gjërat: *langua*.

Dhamë këtu vetëm pak raste, por të mjaftueshme, për të spikatur atë veti, cilësi a tipar të një kafshe, që bëhet motiv i metaforizimit kuptimor, duke shërbyer si semantemë e kuptimit të figurshëm në emërtimin e njerëzve sipas tyre. Por të tilla motive për semantema ka pa fund në të gjitha fushat e jetës, në frymorë e jofrymorë, konkrete e abstrakte, të rendit të dytë a të tretë, të katërt etj. të figurshmërisë. Këto motive në bazë të semantemave përbëjnë specifikën e prejardhjes kuptimore, të kuptimformimit për çdo fushë.

**2. Emërtime njerëzish me emra kafshësh të egra:** *akrep* “kafshë helmuese me ngjyrë të zezë, me dy gërthapë përpara dhe me një thumb të përkulshëm nga pas”, “njeri dorështrënguar” dhe “njeri shpirtkeq, i pabesë e tinëzar”; *ari* “kafshë e egër me trup të madh e të rëndë” dhe “njeri i rëndë e i ngathët, por i fortë; njeri i pagdhundur e i vrazhdë”; *arushë* “kafshë e egër me trup të madh e të rëndë” dhe “njeri i fuqishëm e i guximshëm; njeri që nuk lodhet kurrë”; *begun* “lepur i vogël” dhe “njeri frikacak”; *bishë*

“kafshë e egër grabitqare” dhe “njeri shumë i egër e mizor”; *çakall* “kafshë grabitqare që nxjerr një angullimë të fortë” dhe “njeri gjakpirës e i pangopur, që kërcënon të tjerët duke ulëritur”; *dre* “kafshë gjitare e shkathët” dhe “djalë shumë i shpejtë e i shkathët”; *dhelpër* “kafshë dinake” dhe “njeri shumë dinak”; *egërsirë* “kafshë e egër grabitqare” dhe “njeri shumë i egër e shpirtkazmë; njeri i pamëshirshëm, mizor e i vrazhdë; njeri që sillet keq me të tjerët”; *elefant* “kafshë me trup shumë të madh e të rëndë” dhe “njeri me trup të madh e të trashë, i rëndë në të ecur”; *hienë* “kafshë e egër grabitqare, që ushqehet me kërma” dhe “njeri gjakpirës, grabitqar e i pamëshirshëm”; *hipopotam* “kafshë e egër me trup të madh e të rëndë, me kokë katërkëndëshe e me gojë të gjerë” dhe “njeri me trup shumë të madh e me fytyrë të shëmtuar, i ngathët në të ecur”; *kaproll* “gjitar me këmbë të holla e të shkathëta” dhe “djalë a burrë i shëndoshë, i fuqishëm dhe i shkathët”; *lepur* “kafshë që rend shumë shpejt dhe që njihet si frikacake”, “njeri që ka frikë shumë” dhe “njeri shumë i shpejtë në të ecur”; *luan* “kafshë e egër, më e forta në përlshje me të tjerat” dhe “njeri trim, guximtar e i fortë”; femërore: *luaneshë*; *mi* “gjitar i vogël me feçkë të zgjatur, që rri vrimave dhe ushqehet me mbeturinat e ushqimeve” dhe “njeri pa vlerë e frikacak; njeri që rri fshehur nëpër vende të mbyllura e të errëta e që e ka zakon të kërkojë diçka vrimave, ose që punon a vepron fshehurazi”; *skile* “kafshë si dhelpër, dinake” dhe “njeri dredharak, dinak”; *sorkadh* “gjitar me këmbë të holla e të shkathëta” dhe “djalë me trup të hajthëm e të hedhur, shumë i lehtë e i shkathët” femërore: *sorkadhe*; *sutë* “kafshë gjitare e shkathët dhe e urtë” dhe “vajzë e hijshme dhe e shkathët; vajzë e urtë dhe e butë”; *shtazë* “kafshë” dhe “njeri i trashë e i pasjellshëm; njeri i egër, mizor e i pamëshirshëm”; *tigër* “kafshë e egër, e fortë, e shpejtë e grabitqare” dhe “njeri i egër e mizor” etj.

Emërtimi i njerëzve me emra kafshësh të egra bëhet sipas cilësive a karakteristikave të këtyre kafshëve, ndër të cilat po përmendim: a) frika e lepurit, sipas së cilës emërtohet një njeri frikacak: *begun*, *lepur*; b) butësia e femrës së drerit, sipas së cilës emërtohet një vajzë a nuse e urtë dhe e butë: *drenushë*; c) dinakëria e një kafshe, sipas së cilës emërtohet një njeri shumë dinak: *dhelpër*, *skile*; ç) forca e një kafshe, sipas së cilës emërtohet një njeri trim, guximtar dhe i fortë: *luan*, *luaneshë*, *tiger*; d) endja e rrjetave të dendura prej fijesh shumë të holla nga një kafshë për të kapur gjahun, sipas së cilës emërtohet një njeri që i ngjitet dikujt dhe e dëmton: *merimangë*; dh) shkathhtësia e shpejtësia e kafshëve, sipas të cilave emërtohet një djalë shumë i shpejtë e i shkathët: *dre*, *kaproll*, *lepur*, *sorkadhe*, *sutë*; e) aftësia

helmuese e një kafshe, sipas së cilës emërtohet një njeri shpirtkeq, tinëzar, i rrezikshëm e i pabesë: *akrep*.

Si motive për semantemë mund të shërbejnë edhe më shumë se një cilësi, karakteristikë a tipar i kafshëve; në këtë rast emërtimi i njerëzve me këta emra përfshin në shenjim aq sema sa përfaqësojnë cilësitë, karakteristikat a tiparet e kafshëve: a) madhësia e trupit + pesha e rëndë + ngathësia e një kafshe, sipas të cilave emërtohet një njeri me trup të madh e të trashë; një njeri i rëndë e i ngathët; një njeri i pagdhundur, që sillet në mënyrë të vrazhdë: *ari, arushë, elefant, hipopotam, rinoqeront*; b) bukuria + shkathësia + butësia e një kafshe, sipas të cilave emërtohet një vajzë e hijshme, e bukur dhe e shkathët; një vajzë e urtë dhe e butë: *drenushë, sorkadhe, sutë*; c) egërsia + pavetëdija e kafshëve, sipas të cilave emërtohet një njeri i trashë, që s'kupton asgjë; një njeri i egër, mizor e i pamëshirshëm: *bishë, hajvan, kafshë, shtazë*; ç) egërsia + aftësia rrëmbyese + mënyra e të ushqyerit të një kafshe, sipas të cilave emërtohet një njeri i pamëshirshëm, gjakpirës, grabitqar e i ndyrë: *hienë*; d) egërsia + angullima + aftësia rrëmbyese e një kafshe, sipas të cilave emërtohet një njeri gjakpirës dhe i pangopur; një njeri që ulërin duke kërcënuar të tjerët: *çakall*.

**3. Emërtime njerëzish me emra shpendësh:** *bibë* “zog pate” dhe “grua ose vajzë e trashë nga mendja, budallaqë”; *bilbil* “zog që njihet si këngëtari më i mirë ndër gjithë zogjtë” dhe “njeri që këndon shumë bukur; njeri që flet shpejt e bukur; njeri i mprehtë, që e kap shpejt diçka”; *buf* “shpend me kokë të madhe e të rrumbullakët, që këndon natën sikur vajton”, “djallë a burrë me flokë të paqethur, të pakrehur e të shpupurishur; burrë i parruar prej shumë ditësh; dhe “njeri i plogët e i trashë nga mendja, matuf, torollak”; femërore: *bufe; ciripupe* “zog që ecën duke kërcyer” dhe “njeri shumë mendjelehtë e i paqëndrueshëm”; *çafkë* “shpend me qafë e me këmbë të gjata” dhe “grua e dobët dhe e hollë”; *çotë* “zog që nxjerr një zë të çjerrë” dhe “vajzë a grua mendjelehtë, që grindet vazhdimisht me të tjerët”; *dudi* “zog me pendë e pupla në ngjyrë të kuqe të çelur, të përzier me të verdhë e të bardhë, dhe me një njollë të harkuar pas qafës” dhe “vajzë a grua shumë e bukur e tërheqëse”; *fajkua* “shpend grabitqar me kthetra të forta” dhe “njeri i gjallë, i shkathët, trim e guximtar”; fugë “zog me trup të vogël, i hirtë” dhe “vajzë trupvogël, e shëndoshë dhe e ngathët”; *gallof* “zog me kokë të përhimë dhe me krahë e bisht të zi, i plogët” dhe “njeri me trup të madh, jo të shkathët e të pahijshëm; njeri i trashë nga mendja”; *gollak* “gjel me këmbë të gjata, që këndon me një zë të trashë e të ngjirur”, “njeri që e ka zërin të trashë e të ngjirur” dhe “njeri mendjelehtë”; *grifshë*

“zog i lëvizshëm e me zë të çjerrë” dhe “grua a vajzë llafazane e grindavece, që çirret e bërtet shumë”; *gufkë* “pulë me një xhufkë pendësh në gjoks” dhe “vajzë a grua bullafiqe”; *gugash* “shpend me trup të mbuluar me pendë ngjyrë hiri në të kaltër e me krahë të larmë” dhe “djalë i pastër e i bukur”; *guguçe* “zog me pendë e pupla në ngjyrë të kuqe të çelur, të përziera me të verdhë e të bardhë dhe me një njollë të harkuar pas qafës” dhe “vajzë e pastër, e bukur e lozonjare”; *guguftu* “zog me pendë e pupla në ngjyrë të kuqe të çelur, të përziera me të verdhë e të bardhë” dhe “vajzë e bukur e lozonjare”; *guhak* “pëllumb i egër me pendë të hirta, që qëndron gjatë diku pa lëvizur” dhe “njeri i hutuar e i pavëmendshëm; njeri i trashë nga mendja”; *gjel* “këndes” dhe “njeri mendjemadh e kapadai; njeri që fryhet e ngrëfuset dhe e mban veten për më kryesorin; njeri që kërkon vetëm grindje”; *gjeluc* “gjel i vogël e shumë i dobët” dhe “njeri mburravec, por i dobët e i pazoti”; *gjelkokosh* “këndes” dhe “njeri kapadai e mendjemadh”; *gjeraqinë* “shpend i shkathët e grabitqar” dhe “grua e shpejtë dhe e shkathët”; *hut* “shpend me kokë të madhe e të rumbullakët, që këndon natën sikur vajton” dhe “njeri i trashë nga mendja; njeri i shushatur e matuf”; *kaposh* “këndes” dhe “njeri që shet mend, që ngrëfuset si gjel dhe mburret, njeri mendjemadh”; *kanarinë* “zog i bukur këngëtar me pupla zakonisht të verdha” dhe “vajzë e hijshme, që ka zë të bukur”; *karabullak* “shpend i madh...” dhe “njeri me trup të madh, i trashë nga mendja, budalla”; *këndes* “shpend shtëpiak me lafshë mbi kokë e me bisht të kthyer” dhe “njeri që shet mend, njeri mendjemadh, që ngrëfuset e kapardiset”; *kokosh* “këndes” dhe “njeri mendjemadh, që kapardiset e shet mend”; *laraskë* “shpend me bisht të gjatë dhe me pendë lara-lara, që nxjerr një zë të çjerrë” dhe “vajzë a grua jo e hijshme, me trup të dobët e të thatë, llafazane e grindavece”; *lejlek* “shpend me qafë e me sqep të gjatë dhe me këmbë të gjata” dhe “njeri me trup të hollë, me shalë të gjata e me trup të gjatë”; *mjellmë* “shpend i bukur, më i madh se pata, me qafë të gjatë e të lakueshme, me pendë zakonisht të bardha e të shkëlqyeshme” dhe “vajzë a grua e re, e bukur dhe e urtë”; *papagall* “zog me pendë ngjyra-ngjyra, që ka aftësi të shqiptojë fjalë duke imituar njeriun” dhe “njeri që flet a përsërit në mënyrë mekanike fjalët e një tjetri, pa u thelluar në ato që thotë”; *petrit* “shpend grabitqar me thonj e krahë të fuqishëm” dhe “djalë a burrë i ri, trim, i fuqishëm, i shkathët e guximtar”; *pëllumb* “shpend i bukur, zakonisht me pendë të bardha, që mbahet si simbol i butësisë, i pastërtisë, i bukurisë e i paqes” dhe “fëmijë a djalë i vogël, i bukur dhe i dashur”; *pulë* “shpend shtëpiak, me trup të vogël, që bën vezë” dhe “njeri i urtë, i shtruar, i bindur, i heshtur e i ndrojtur; njeri frikacak që nënshtrohet lehtë”; *rroc*

“pëllumb i bardhë, pa kaçul” dhe “fëmijë i vogël e i shëndetshëm”; *skifter* “shpend grabitqar me kthetra të fuqishme” dhe “njeri trim e i vrullshëm në sulm”; *sokol* “shpend grabitqar me krahë e thonj të fuqishëm” dhe “djalë a burrë zakonisht shtathedhur, trim e i zoti”; femërore: *sokoleshë* “vajzë a grua, zakonisht shtathedhur, që shquhet për trimëri e për shkathësi në punë”; *spurdhjak* “zog i vogël e i dobët” dhe “fëmijë i vogël e pa përvojë, kalama”; femërore: *spurdhjake* “vajzë e vogël e pa përvojë”; *thëllëzë* “zog i bukur e që këndon bukur” dhe “vajzë a nuse e bukur”; *vide* “pëllumb femër” dhe “grua e bukur”; *zogëz* “pulë e re” dhe “vajzë a grua e re dhe e bukur”.

Siç shihet, emërtimi i njerëzve me emra shpendësh bëhet sipas disa cilësive të këtyre të fundit, ndër to mund të përmendim: a) madhësia e trupit të shpendit, sipas së cilës emërtohet një grua ose vajzë e trashë nga mendja si dhe një njeri me trup të madh e i trashë mendërisht: *bibë, gallof, karabullak, patë*; b) vogëlsia e trupit të një zogu, sipas së cilës emërtohet një vajzë trupvogël, e shëndoshë dhe e ngathët; një fëmijë i vogël plot shëndet; një fëmijë i vogël pa përvojë jetësore: *ferrak, fug, gjeluc, rabeckë, rroc, spurdhjak, spurdhjake, xhixhimës*; c) bukuria fizike e një shpendi, sipas së cilës emërtohet një njeri i bukur: *kanarinë, mjellmë, pëllumb, pëllumbeshë, sokol, vidë*; ç) bukuria e veçoria e zërit të zogjve, sipas së cilës emërtohet një njeri që këndon shumë bukur; që flet shpejt e bukur, që është i mprehtë e që i kap shpejt gjërat: *bilbil, çotë, grifshë, kanarinë, thëllëzë*; d) mënyra e të ecurit të një zogu, sipas së cilës emërtohet një njeri tepër mendjelehtë e i paqëndrueshëm: *bishtatundës, ciripupe, laraskë*; dh) ngjyra e pendëve të shpendit, sipas së cilës emërtohet një djalë i pastër dhe i bukur: *gugash, pëllumb*; e) denduria e pendëve dhe e puplave të shpendit, sipas së cilës emërtohet një njeri mbushalesh; një njeri i hutuar e i pavëmendshëm; një njeri i trashë nga mendja: *buf, guhak, hut*; ë) ngrefosja e fryrja e pendëve të këndesit, sipas së cilës emërtohet një njeri i fryrë, mendjemadh e kapadai; një njeri që ngrefoset duke e mbajtur veten për më kryesorin; një njeri kanosës: *gjel, gjelkokosh, kaposh, këndes, kokosh*; f) aftësia rrëmbyese e një shpendi grabitqar, sipas së cilës emërtohet një njeri i shpejtë dhe i shkathët: *gjerakinë, petrit, skifter*; g) gjatësia e qafës, e sqepit dhe e këmbëve të një shpendi, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup të hollë, me shalë të gjata dhe me qafë të gjatë: *lejlek*; gj) aftësia e një shpendi për të imituar njeriun, sipas së cilës emërtohet një njeri që flet a që përsërit në mënyrë mekanike fjalët e një tjetri, pa u thelluar në ato që thotë: *pa-pagall*; h) mosha e re e shpendit, sipas së cilës emërtohet një vajzë a grua e re dhe e bukur: zog, zogëz.

Edhe këtu kemi raste kur si motiv i semantemës të emërtimeve shërbejnë dy a më shumë cilësi, karakteristika a tipare të shpendëve: a) ngjyra e pendëve a e puplave + forma e një shenje të veçantë në qafë, sipas të cilave emërtohet një vajzë a grua shumë e bukur e tërheqëse, si edhe një vajzë e pastër dhe e bukur: *dudi, guguçe, guguftu*; b) aftësia rrëmbyese + fortësia e kthetrave të një shpendi, sipas të cilave emërtohet një njeri i gjallë, i shkathët, trim e guximtar: *fajkua, skifter*; c) madhësia e trupit + veçoria e zërit të shpendit, sipas të cilave emërtohet një njeri zëtrashë e mendjelehtë: *gollak*; ç) bukuria e trupit + bukuria e zërit të një zogu këngëtar, sipas të cilave emërtohet një vajzë e hijshme që ka zë të bukur: *bilbil, kanarinë, pëllumb, pëllumbeshë*; d) madhësia e kokës + forma e kokës + mënyra e të kënduarit të një shpendi grabitqar, sipas të cilave emërtohet një djalë a burrë me flokë të paqethur, të pakrehur e të shpupurishur; një burrë i parruar prej shumë ditësh; një njeri i plogët dhe i trashë nga mendja: *buf, gallof, hut, kukumjaçkë*; dh) gjatësia e këmbëve + gjatësia e qafës + hollësia e sqepit të një shpendi uji, sipas të cilave emërtohet një njeri i dobët dhe i hollë: *çafkë, lejlek*; e) gjatësia e bishtit + ngjyra e pendëve + veçoria e zërit të një shpendi, sipas të cilave emërtohet një vajzë a grua jo e hijshme, me trup të dobët dhe të thatë një grua llafazane e grindavece: *laraskë, sorrë*; ë) butësia + frika + heshtja e një shpendi, sipas të cilave emërtohet një njeri i urtë dhe i ndrojtur, njeri tepër i butë; një njeri frikacak, që nënshtrohet lehtë: *pulë*.

**4. Emërtime njerëzish me emra kandrrash:** *arëz* “kandërr me thumb helmues” dhe “njeri i lig që u bie më qafë të tjerëve dhe u bën të këqija”; *birues* “kandërr dëmtuese që shpon vrima në pemë” dhe “njeri që fut hundët kudo, ai që përzihet në punët e të tjerëve, biramel”; *buburrec* “kandërr e vogël” dhe “njeri me trup të vogël”; *cilivile* “kandërr e vogël që ndrit si një xixë, që ndizet dhe shuhet natën” dhe “vajzë e shkathët dhe e zgjuar”; *çikëlore* “kandërr e vogël që ndrit si një xixë, që ndizet dhe fiket natën” dhe “grua mendjelehtë”; *flutur* “kandërr fluturuese” dhe “grua, nuse a vajzë shumë e shpejtë dhe e shkathët; grua a vajzë shumë e lehtë”, *grerëz* “kandërr që ka një thumb helmues” dhe “njeri që kërkon t’u bëjë keq të tjerëve, njeri i lig, keqbërës”; *gjinkallë* “kandërr që lëshon në vapë një zë të zgjatur dhe gumëzhitës” dhe “njeri që nuk i pushon goja, llafazan”; *karkalac* “kandërr me këmbë të gjata që kërcen me shkathësi dhe fluturon larg” dhe “njeri me trup të gjatë, të hollë e të dobët; njeri me trup të lehtë që lëviz dhe kërcen shumë”; *këpushë* “parazit që u ngjitet në lëkurë bagëtime etj., u thith gjakun dhe u shkakton sëmundje ngjitëse” dhe “njeri parazit që rron

në kurriz të të tjerëve; njeri që të ngjitet dhe s` të ndahet”; *karavidhe* “kafshë me dhjetë këmbë, të cilat i japin mundësi të ecë në të gjitha drejtimet” dhe “njeri shumë i lëvizshëm, që s`zë vend; njeri i paqëndrueshëm dhe dredharak, që vetë s`rri i qetë e s`lë të qetë as të tjerët”; *kacagjel* “milingonë e madhe me birth përpetë” dhe “njeri që ngrefoset dhe kapardiset si gjel; njeri që kujton se është shumë i zoti dhe mburret përpara të tjerëve”; *kërpudhë* “mikroorganizëm parazitar, që shumëzohet me spore dhe zhvillohet në trupin e një bime ose në ushqime” dhe “njeri i padëshirueshëm që shfaqet papritur diku dhe bën jetë parazitare”; *ligavec* “lloj kërmilli pa guaskë” dhe “njeri i squllët dhe i fllashkët, që hiqet zvarrë gjithë jetën; njeri që s`vepron me guxim, njeri pa kockë, qaraman”; *mikrob* “organizëm tepër i vogël njëqelizor që kalbëzon dhe tharbëton lëndë organike ose shkakton sëmundje të ndryshme” dhe “njeri parazit, i dëmshëm për shoqërinë; njeri që s`na ndahet, që na mërzi shumë dhe nuk e durojmë dot”; *mol* “kandërr që bren sendet e leshta, gëzofët, drithërat, sendet e ndryshme” dhe “njeri që të qepet dhe s` të ndahet, njeri që të bren dhe të ha shpirtin”; *murrjelë* “kandërr që pickon gjedhin dhe i pi gjakun” dhe “njeri që s` të lë rehat, që të ngacmon vazhdimisht”; *pulith* “kandërr që rron si parazit” dhe “njeri tinëzar; mistrec”; *pilivesë* “kandërr me trup të hollë dhe krahë të gjatë” dhe “vajzë e hajthme dhe lozonjare”; *plesht* “parazit që kërcen shumë, pickon dhe thith gjak” dhe “njeri jo i mirë, i paqëndrueshëm e i mërziqshëm”; *rojke* “bletë që ikin nga zgjoi i vet” dhe “grua llafazane”; *shkëndijëz* “kandërr që ndrit si xixë e që ndizet dhe shuhet natën” dhe “njeri i shkathët dhe i shpejtë në punë dhe në veprime”; *shushunjë* “krimb parazitar që u ngitet kafshëve në trupin e tyre për t`u pirë gjakun”, “njeri që të ngitet e s` të ndahet për një punë të tijën” dhe “shfrytëzues i egër dhe i pashpirt, gjakpirës”; *tartabiqe* “kandërr e vogël që u thith njerëzve gjakun natën kur flenë”, “grua a vajzë shtatvogël dhe e imtë” dhe “njeri që të mërzi vazhdimisht për punët e veta, njeri i bezdisshëm dhe i pacipë”; *mizë* “kandërr e vogël fluturuese”, “njeri me trup fare të vogël” dhe “njeri pa vlerë, pa rëndësi; njeri i dobët, pa forcë që mund të mposhtet lehtë”; *xixëllonjë* “kandërr e vogël që ndrit si xixë e që ndizet e shuhet natën” dhe “vajzë a grua mendjelehtë, që i pëlqen të duket dhe të bredhë e që s`di ta ruajë bukurinë dhe nderin e vet” etj.

Emërtimi i njerëzve me emra kandrrash ka si burim disa cilësi të tyre, ndër të cilat mund të përmendim: a) mënyra e të ushqyerit të disa kandrrave dëmtuese (shpojnë vrima në pemë), sipas së cilës emërtohet një njeri që fut hundët kudo, që përzihet në punët e të tjerëve: *birues*; b) vogëlsia e trupit të një kandrre me krahë të fortë, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup të vogël: *buburrec*; c) lehtësia e lëvizjes së disa kandrrave fluturuese, sipas të

cilës emërtohet një vajzë a nuse shumë e shpejtë, e shkathët dhe e lehtë: *flutur*; d) aftësia thumbuese a helmuese e kandrrës, sipas së cilës emërtohet një njeri që kërkon t'u bëjë keq të tjerëve, një njeri i lig dhe keqbërës: *grerëz*; dh) kohëzgjatja e gumëzhitjes së zërit të kandrrës, sipas së cilës emërtohet një njeri që nuk i pushon goja, një njeri llafazan: *gjinkallë*; e) aftësia për të ecur në të gjitha drejtimet e gaforres sipas së cilës emërtohet një njeri tepër i lëvizshëm, që s'zë vend; një njeri i paqëndrueshëm e dredharak, që vetë nuk rri i qetë e s'le të qetë as të tjerët: *karavidhe*; ë) aftësia brejtëse e një kandrre me dy palë krahë, sipas së cilës emërtohet një njeri që të qepet e s'të ndahet, një njeri që të bren e të ha shpirtin: *mole*; f) vogëlsia e trupit dhe e krahëve të një kandrre fluturuese, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup fare të vogël, si dhe një njeri pa vlerë e rëndësi; një njeri i dobët, pa forcë, që mund të nënshtrohet lehtë: *mizë*; g) aftësia e zekthit për të pickuar dhe për të thithur gjakun, sipas së cilës emërtohet një njeri që s'të le rehat, që të ngacmon vazhdimisht: *murrjelë*; gj) parazitizmi i thërijës së morrit të pulave, sipas së cilës emërtohet një njeri tinëzar dhe mistrec: *pulith*; h) hollësia e trupit të një kandrre, sipas së cilës emërtohet një vajzë e hajthme dhe lozonjare: *pilivesë*; i) mënyra se si ndriçon natën në fillim të verës (duke u fikur dhe duke u ndezur brenda më pak se një sekondë), sipas së cilës emërtohet një njeri i shkathët dhe i shpejtë në punë dhe në veprime: *shkëndijëz*; j) aftësia thumbuese + mënyra e të ushqyerit të një kandrre të vogël sa bleta, sipas të cilave emërtohet një njeri i lig që u bie në qafë të tjerëve e u bën të këqija: *arëz*; k) lehtësia e fluturimit + mënyra se si ndriçon natën në fillim të verës (duke u fikur dhe duke u ndezur brenda më pak se një sekonde), sipas të cilave emërtohet një vajzë e shkathët dhe e zgjuar, një grua mendjelehtë, si dhe një vajzë a grua e lehtë nga mendja, që i pëlqen të duket e të bredhë e që s'di ta ruajë bukurinë dhe nderin e vet: *cilivile, çikëlore, xixëllonjë*; l) madhësia e trupit + pozicioni i mbajtjes së një pjese të tij (me brirëth përjetë) të një milingone të madhe, sipas të cilave emërtohet një njeri që ngrefoset dhe kapardiset si gjel; një njeri që kujton se është shumë i zoti e mburret përpara të tjerëve: *kacagjel*; ll) parazitizmi + aftësia për të thithur gjak e një parazit të vogël në trajtën e një merimange, sipas të cilave emërtohet një njeri parazit që rron në kurriz të të tjerëve; një njeri që të ngjitet e s'të ndahet: *këpushë*; m) mënyra e të ushqyerit (kalbëzon e tharbëton lëndët organike duke shkaktuar sëmundje të ndryshme) + parazitizmi i një organizmi tepër të vogël njëqelizor, sipas të cilave emërtohet një njeri parazit, i dëmshëm për shoqërinë, njeri që s'të ndahet e që të mërzi shumë duke u bërë i padurueshëm: *mikrob*; n) aftësia për t'u ngjitur në trupin e njerëzve e të kafshëve që të thithë gjakun e tyre +

parazitizmi i një krimbi të ujërave të ëmbla, sipas të cilave emërtohet një njeri që të ngjitet e s` të ndahet për një punë të tijën, si dhe një njeri i egër e i pashpirt që shfrytëzon mizorisht të tjerët: *shushunjë*; nj) vogëlsia e trupit + aftësia për të thithur gjak e një kandrre të vogël sipas të cilave emërtohet një grua a vajzë shtatvogël dhe e imët, si dhe një njeri që të mërzit vazhdimisht për punët e veta, një njeri i bezdisshëm dhe i pacipë: *tartabiqe*; o) butësia e trupit + mënyra e lëvizjes (duke u zvarritur për tokë) e një lloji kërmilli pa guaskë, sipas të cilave emërtohet një njeri i squllët dhe i fllashkët, që hiqet zvarrë gjithë jetën; një njeri pa kockë që s`vepron me guxim: *ligavec*; p) kërcyeshmëria + aftësia për të thithur gjak e një paraziti tepër të vogël, sipas të cilave emërtohet një njeri jo i mirë, i paqëndrueshëm e i mërzitshëm: *plesht*; q) madhësia e trupit + gjatësia e këmbëve + shkathësia në kërcim + aftësia për të fluturuar larg e një kandrre, sipas të cilave emërtohet një njeri me trup të gjatë, të hollë e të dobët; një njeri me trup të lehtë që lëviz dhe kërcen shumë: *karkalec*.

**5. Emërtime njerëzish me emra zvarranikësh:** *astrit* “gjarpër i madh, i shpejtë dhe i shkathët” dhe “njeri shumë i shkathët, trim e sypatrembur”; *bullar* “gjarpër me trup të trashë e mjaft i ngathët në lëvizje” dhe “djallë a burrë trashalug ose i ngathët”; *gjarpër* “zvarranik pa këmbë, me trup të lakueshëm e dredhues, që i ka dhëmbët me helm ose që i mbështillet gjahut rreth e qark dhe e shtrëngon”, “njeri i keq dhe i pabesë, njeri dinak” dhe “njeri tepër i shkathët, shumë i gjallë dhe trim”; *gjarpërushe* “zvarranik pa këmbë, me trup të lakueshëm e dredhues” dhe “grua zemërligë e ngatërrrestare”; *kameleon* “zvarranik që ndërron ngjyrën e lëkurës në përshtatje me ngjyrën e mjedisit ku ndodhet” dhe “njeri i lëkundshëm dhe me shumë faqe, që ndërron shpesh qëndrimin a sjelljen për të mbrojtur interesat e veta”; *krokodil* “rëshqanor i madh me kokë të shtypur, me gojë të madhe dhe me dhëmbë të fortë” dhe “njeri që përdor metoda mashtruese për të kënaqur dëshirat e tij të mbrapshta”; *nepërkë* “gjarpër helmues, me dy dhëmbë në gojë” dhe “njeri shumë i keq dhe i pabesë; njeri tepër i djallëzuar e tinëzar; njeri që e ka gjuhën të hidhur e të mprehtë, që të ther e të helmon me fjalë”; *shlligë* “gjarpër helmues” dhe “grua e keqe dhe gjuhustër, nepërkë”; *zvarranik* “kafshë me këmbë të shkurtra që lëviz duke u zvarritur për tokë”, “njeri që zvarritet në jetë, njeri i prapambetur dhe që s`ecën me një hap me të tjerët” dhe “ai që përulet përpara të tjerëve, ai që bëhet urë e vig; njeri puthador” etj.

Nga sa shihet, emërtimi i njerëzve me emra zvarranikësh bëhet sipas disa cilësive të jashtme të tyre, ndër të cilat po përmendim: a) aftësia për t`u

përshtatur me mjedisin e një zvarraniku të vendeve të ngrohta, sipas së cilës emërtohet një njeri i lëkundshëm dhe me shumë faqe, që ndërron shpesh qëndrimin a sjelljen për të mbrojtur interesat e veta: *kameleon*; b) mënyra e të ecurit (duke rrëshqitur a duke u zvarritur) të një rrëshqanori a kafshe kërbishtore (si gjarpri, nepërka, hardhuca etj), sipas së cilës emërtohet një njeri që përdor metoda mashtruese për të kënaqur dëshirat e tij të mbrapshta, një njeri që zvarritet në jetë, që mbetet mbrapa dhe nuk ecën me një hap me të tjerët, si dhe një njeri që përulet para të tjerëve, që bëhet urë e vig i tyre e që u puth këmbët të tjerëve: *krokodil*, *zvarranik*; c) mënyra se si e sulmon prenë gjarpri helmues, sipas së cilës emërtohet një njeri shumë i keq dhe i pabesë; një njeri tepër i djallëzuar e tinëzar, që e ka gjuhën të hidhur e të mprehtë dhe që të ther e të helmon me fjalë, si edhe një grua e keqe e gjuhustër: *nepërkë*, *shlligë*; d) shpejtësia + shkathtësia e një gjarpri të madh, sipas të cilave emërtohet një njeri shumë i shkathët, trim e sypatrembur: *astrit*; dh) trashësia e trupit + ngathtësia në lëvizje të një gjarpri johelmues, sipas të cilave emërtohet një djalë a burrë trashalug ose i ngathët: *bullar*; e) zhdërvjelltësia + lakueshmëria e trupit të femrës së gjarprit, sipas të cilave emërtohet një grua zemërligë e ngatërrestare: *gjarpërushe*; ë) mungesa e një pjese të trupit + mënyra se si e sulmon prenë + zhdërvjelltësia e një zvarraniku pa këmbë, sipas të cilave emërtohet një njeri i keq dhe i pabesë, një njeri dinak, si dhe një njeri shumë i shkathët, tepër i gjallë e trim: *gjarpër*.

**6. Emërtime njerëzish me emra peshqish:** *balenë* "gjitarr me trup të madh e të rëndë" dhe "vajzë a grua me trup të madh, e ngathët në të ecur"; *çafër* "peshk i gjatë, me bark të gjerë" dhe "fëmijë i shkathët dhe i mprehtë"; *fokë* "gjitarr me trup të madh, me qafë të shkurtër dhe me këmbë si lopatë" dhe "njeri i trashë, i rëndë e i ngathët, që lëviz me vështirësi"; *krap* "peshk i madh" dhe "njeri i trashë nga mendja dhe jo i shkathët"; *levrek* "peshk që noton shpejt" dhe "njeri me trup të hajthëm e të shkathët"; *mlysh* "peshk me trup gjatosh e me turi petashuq" dhe "njeri i trashë nga mendja, budalla"; *ngjalë* "peshk me trup të gjatë e të hollë si të gjarprit" dhe "njeri dredharak që di t'u bëjë bisht e t'u shpëtojë gjendjeve të vështira"; *oktapod* "butak me tetë krahë, që lëshon një lëng të zi për t'u mbrojtur" dhe "njeri i lig dhe i djallëzuar, që përpiqet ta shtrijë sa më gjerë e pa zhurmë veprimtarinë e vet të dëmshme"; *peshkaqen* "peshk grabitqar, me trup të madh e të fuqishëm, me dhëmbë të fortë e të mprehtë" dhe "njeri grabitqar e i pamëshirshëm, që sulmon të tjerët dhe i shfrytëzon egërsisht; ai që pasurohet duke shfrytëzuar

pa mëshirë të tjerët”; *qefull* “peshk me trup të gjatë dhe të hollë” dhe ”burrë a djalë i gjatë, i hollë dhe i hijshëm” etj.

Emërtimi i njerëzve me emra peshqish bëhet zakonisht sipas disa cilësive, nga të cilat mund të përmendim: a) gjerësia e barkut të një peshku pendëkuq të ujërave të ëmbla, sipas së cilës emërtohet një fëmijë i shkathët dhe i mprehtë: *çafrrë*; b) madhësia e trupit të një gjitari të deteve polare, sipas së cilës emërtohet një njeri i trashë, i rëndë dhe i ngathët në lëvizje: *fokë, krap*; c) shpejtësia në të notuar e një peshku të ujërave të kripura, sipas së cilës emërtohet një njeri me trup të hajthëm e të shkathët: *levrek*; d) forma gjatoshë e trupit të një peshku grabitqar të ujërave të ëmbla, sipas së cilës emërtohet një njeri i trashë nga mendja, një njeri budalla: *mlysh*; dh) sasia e krahëve të një tetëkëmbëshi, sipas së cilës emërtohet një njeri i lig dhe i djallëzuar, që përpiqet ta shtrijë sa më gjerë e pa zhurmë veprimtarinë e vet të dëmshme: *oktapod*; e) gjatësia dhe hollësia e trupit + mënyra e të ecurit të një peshku që rron në det dhe në ujëra të ëmbla, sipas të cilave emërtohet një njeri dredharak, që di t`u bëjë bisht dhe t`u shpëtojë gjendjeve të vështira: *ngjalë*; ë) gjatësia + hollësia e trupit të një peshku të ujërave të kripura dhe të ëmbla, sipas të cilave emërtohet një njeri i gjatë, i hollë dhe i hijshëm: *qefull*; f) aftësia rrëmbyese + madhësia e fuqia e trupit + fortësia e mprehtësia e dhëmbëve të një peshku deti grabitqar, sipas të cilave emërtohet një njeri grabitqar dhe i pamëshirshëm, që sulmon të tjerët dhe i shfrytëzon egërsisht; ai që pasurohet duke shfrytëzuar pa mëshirë të tjerët: *peshkaqen*.

Fushën leksikore të emërtimeve të njerëzve me emra të botës shtazore mund ta paraqesim edhe me tabelën e mëposhtme:

### Fusha leksikore e emërtimeve të njerëzve me emra të botës shtazore

Nr. mikrofusha leksikore kuptime	përbërësit semantikë	
	të kuptimit të parë	në funksion të semantemës
1 emërtime njerëzish me emra kafshësh shtëpiake	280	60
		të figurshme 75

2 emërtime njerëzish me emra kafshësh të egra	100	30	25
3 emërtime njerëzish me emra shpendësh	200	45	55
4 emërtime njerëzish me emra kandrrash	80	25	30
5 emërtime njerëzish me emra zvarranikësh	80	20	25
6 emërtime njerëzish me emra peshqish	40	15	15

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme mund të bëjmë, të paktën, dy vëzhgime kryesore:

**së pari**, numri i përbërësve semantikë a i semave të pranishme në kuptimet e para të emrave të botës shtazore i afrohet shifrës 800, kurse numri i përbërësve kuptimorë në funksion të semantemës a të temës semantike është më shumë se  $1/3$  e tyre që do të thotë se emrat e kësaj fushe leksikore kanë potencia të mëdha zhvillimi kuptimor në të ardhmen pasi, sipas shifrave, janë edhe gati 500 sema a përbërës kuptimorë të pashfrytëzuar deri tani në procesin e risemantizimit të emrave që kemi bërë objekt të analizës sonë;

**së dyti**, numri i kuptimeve të figurshme që kanë përfutur emrat e botës shtazore në procesin e risemantizimit e kalon shifrën 200, por ajo që vlen të thuhet është se një pjesë e mirë e këtyre emrave kanë përfutur dy a më shumë kuptime metaforike mbi bazën e një teme të vetme semantike. Kështu, p.sh. emri *derr*, me gjashtë përbërës kuptimorë të pranishëm në kuptimin e parë, ka përfutur tre kuptime të figurshme metaforike që karakterizojnë njeriun sipas tipareve fizike e morale njëkohësisht, mbi bazën e një tipari të vetëm: *trashësisë së trupit e të qafës*, ndërkaq ky emër ka edhe pesë përbërës apo sema të tjera që mund të bëhen aktive ndër vite. Kjo tregon edhe një herë se përmasat e rikuptimësimit të emrave të botës shtazore në të ardhmen në gjuhën shqipe do të jenë gjithnjë e më të mëdha.

Duke i parë në tërësi emërtimet e njerëzve me emra të botës shtazore, mund të nxjerrim disa përfundime më të përgjithshme:

1. Emërtimi i njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe bëhet edhe me emra të botës shtazore, të cilët risemantizohen në procesin e metaforizimit gjuhësor e përftojnë kuptime të figurshme që karakterizojnë njerëzit sipas pamjes fizike e tipareve morale. Kalimi nga kuptimi i pamjes a kuptimi historik fillestar i këtyre emrave te kuptimi i figurshëm metaforik bëhet sipas një tipari të spikatur të realies që shenjohet prej tyre, tipar i cili merr vlera të figurshme në njësinë e re që krijohet. *Kalime ose shndërrime të tilla në gjuhën shqipe janë një dukuri e zakonshme, një hallkë e tipizuar, për të cilën mund të thuhet se përbën një model (gjedhe) të lëvizjes semantike në shqipe.* Tek emrat e botës shtazore ky model na del me gjashtë shndërrime kuptimore metaforike, të cilat realizohen duke kaluar:

a) nga kuptime që lidhen me kafshë shtëpiake në kuptime që lidhen me njeriun: *bardhonjë 1* “kafshë shtëpiake e bardhë” – *bardhonjë 2* “vajzë a grua me lëkurë shumë të bardhë.

b) nga kuptime që lidhen me emra kafshësh të egra në kuptime që lidhen me njeriun: *ari 1* “kafshë e egër me trup të madh e të rëndë” – *ari 2* “njeri i rëndë e i ngathët, por i fortë; njeri i vrazhdë e i pagdhundur”

c) nga kuptime që lidhen me emra shpendësh në kuptime që lidhen me njeriun: *pëllumb 1* “shpend i bukur, zakonisht me pendë të bardha që mbahet si simbol i butësisë, i bukurisë dhe i paqes” – *pëllumb 2* “fëmijë, djali i vogël, i bukur dhe i dashur”

ç) nga kuptime që lidhen me emra kandrrash në kuptime që lidhen me njeriun: *arëz 1* “kandërr me thumb helmues” – *arëz 2* “njeri i lig që u bie më qafë të tjerëve e u bën të këqija”

d) nga kuptime që lidhen me emra zvarranikësh në kuptime që lidhen me njeriun: *kameleon 1* “zvarranik që ndërron ngjyrën e lëkurës në përshtatje me ngjyrën e mjedisit ku ndodhet” – *kameleon 2* “njeri i lëkundshëm e me shumë faqe, që ndërron shpesh qëndrimin a sjelljen për të mbrojtur interesat e veta”

dh) nga kuptime që lidhen me emra peshqish në kuptime që lidhen me njeriun: *oktapod 1* “peshk me shumë këmbë, me trup të mbledhur si qeskë, me ventuza e me dy sy të mëdhenj” – *oktapod 2* “njeri i lig dhe i djallëzuar; njeri që përpiqet ta zgjerojë pa shumë zhurmë veprimtarinë e vet keqbërëse e të gllabërojë të tjerët”.

2. Përbërësit kuptimorë apo semat që shërbejnë si tema semantike a semantema mbi bazën e të cilave janë përftuar kuptimet e figurshme që karakterizojnë njerëzit sipas cilësive të jashtme dhe atyre morale shprehin gjuhësisht treguesit e tipareve të realieve që shenjohen prej emrave të botës shtazore të përfshirë në procesin e metaforizimit gjuhësor. Si të tillë mund

të përmendim: *ngjyra* (e bardhë, e bardheme, bojëhiri, gri, e kuqe, e zezë etj.); *mosha*; *përmasat* (gjatësia, madhësia, vogëlsia, trashësia, hollësia, gjerësia); *pamja e jashtme*; *aftësia* (brejtëse, helmuese, rrëmbyese, thumbuese, për të gjuajtur, për t'u përshtatur, për të ecur, për të fluturuar, për të pickuar etj.); *pavetëdija*; *butësia*; *urtësia*; *ngathtësia plogështia*; *shkathtësia*; *forca*; *energja*; *shpejtësia*, *frika*; *dinakëria*; *egërsia*; *makutëria a pangopësia*; *bukuria*; *parazitizmi*; *kërcyeshmëria*; *lakueshmëria*; *mënyra e të ecurit*, *mënyra se si e sulmon prenë*; *forma e trupit a pjesëve të tij e ndonjë tjetër*. Vetëm fare pak emra të botës shtazore kanë zhvilluar kuptime të figurshme karakterizuese për njerëzit duke patur si temë semantike përbërës kuptimorë që shprehin gjuhësisht tregues të funksionit a të përdorimit të referentit që shenjohet prej tyre apo tregues të mjedisit e të historisë.

3. Disa emra të kësaj fushe leksikore nuk janë përfshirë në procesin e metaforizimit gjuhësor për të karakterizuar njerëzit sipas tipareve fizike e morale, fjala vjen, *troftë*, ndryshe nga *krap*, nuk metaforizohet, sepse gjuhë-krijuesi, siç duket, nuk gjen ndonjë tipar të spikatur që mund të figurativizohet lehtë e mbi bazën e të cilit të mund të bëhet rikuptimësimi; kurse *salmoni*, duke qenë se nuk jeton në mjedisin shqiptar, pra edhe “i kufizuar” në ligjërimin e zakonshëm shqiptar, nuk ka arritur të përfshihet në procesin e metaforizimit për të cilësuar njerëzit sipas pamjes së jashtme a sipas tipareve të brendshme, sikundër ndodh me *qefull*, *ngjalë* etj.; ndërsa disa emra të tjerë të botës shtazore që i janë nënshtruar procesit të metaforizimit gjuhësor janë kthyer tashmë në simbole të attributeve njerëzore, fjala vjen, dihet që *gomari* është edhe simbol i durimit, por ky tipar nuk përfillet në zhvillimet metaforike në gjuhën shqipe (zakonisht nuk themi “ka durimin e gomarit”, por “ka durimin e derrit”), ai mbetet simbol i ngarkuar për një metaforë “negative”, që karakterizon një “njeri të trashë nga mendja e budalla, pra, simbol i budallallëkut; *dhelpira* e *ujku* janë gjegjësisht simbole të dinakërisë e të pangopësisë etj.

4. Na duket me mjaft interes të vëmë në dukje apo të zbulojmë edhe perceptimin social, “uzusin” e emërtimeve ose, thënë ndryshe, perceptimin shoqëror të dukurisë së metaforizimit gjuhësor a të rikuptimësimit; p.sh., vërtetë *nepërka* është realie për një metaforë “negative” (“- Është nepërkë ajo”), por, kur i këndojmë një vajze të bukur “Moj nepërka pika-pika”, në këtë rast kemi një përdorim shoqëror me kuptim “pozitiv” të fjalës, i cili, siç dihet, nis si përdorim individual, por, me kohë, kalon në përdorim shoqëror; po kështu, dihet që *lepuri* është simbol i frikës, por fëmijën e përkëdhelim kur i themi *lepurush*; dihet si sharje emërtimi *gomar*, për “budalla, i trashë nga mendja”, por, me shaka e përkëdheli babai i thotë djalit të

vet: “- Afrohu këtu, o gomari i babait”; më të qarta janë rastet *gjeraqinë, luan, pëllumb* etj.

Sollëm në këtë artikull mjaft raste që spikatin atë cilësi, veti a tipar të një realieje që shenjon një *kafshë (të egër a shtëpiake), shpend, kandërr, peshk a zvarranik*, i cili bëhet motiv i rikuptimësimit, pra i metaforizimit kuptimor, duke shërbyer si temë semantike a semantemë e kuptimit të figurshëm në emërtimin e njerëzve sipas tyre. Por të tilla motive për semantema a tema semantike ka edhe në fusha të tjera leksikore që emërtojnë njerëzit sipas dukës së jashtme a tipareve të brendshme *me emra të botës bimore, me emra lëndësh, qeniesh mitologjike e besimesh mistiko-fetare, me emra mjetesh, enësh kuzhine e gatesash, me emra sëmundjesh* etj. Këto motive në bazë të temave semantike përbëjnë vetëjakësinë e prejardhjes kuptimore, pra të kuptimformimit për çdo fushë leksiko-semantike të shqipës.

## Literatura

Chafe, L., *Language as Symbolization*, në “Language”, 1967, vol. 43, 1, f. 57-91.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f. 43-79.

Greimas. A. J., *Semantique structurale*, 1972, f. 67.

Katz. J – Fodor. J, *The Structure of a Semantic Theory*, në “Language”, 39, 1963, f. 170 – 210.

Kostallari. A., *Studime për fjalëformimin dhe leksikun*, Vëllimi III, Tiranë 2017, f. 215 – 228.

Memishaj. V., *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, 1999.

Metani. I, *Semantika leksikore e emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe*, 2019.

Nida. E., *Morphology: Analysis of Words*, 1949.

Prieto. L., *Principes de noologie: fondements de la theorie fonctionnelle du signifie*, 1964, f. 64 – 68.

Thomai. J., *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2009.

Vogli. T., *Një vështrim mbi leksikun që lidhet me vetitë fizike e cilësitë morale të njerëzve në zonën e Krutjes*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, 1989, f. 475 – 482.

## **NAMING HUMANS WITH NAMES OF ANIMAL WORLD IN ALBANIAN LANGUAGE**

### **Summary**

The object of the present article is specifically the names of people with names of wildlife, who, within the macro field of names of people according to physical and moral features as a whole, form a lexical-semantic field that carries some general features: a) is unified from the lexico-grammatical, lexico-word-forming and lexico-semantic point of view; b) has internal systemic ideographic connections both from the point of view of the source of the names, as well as from the point of view of marking and characterization, according to a regular typology; c) has undergone semantic development and movement that can be described and systematized into larger semantic categories.

The main purpose of the article is to look at the whole lexical field of the names of people with wildlife names to see more closely and in depth all the semantic development that have occurred in it by analyzing especially the metaphorical blocks that are created, along with other semantic blocks, within the semantic structure of words, but we have called them here metaphorical, to show that the semantic derivation of the nouns we are talking about has based on the metaphor, as one of the main transplants on the basis of which these names have been reinterpreted thus obtaining figurative meanings that characterize people according to physical and moral features.